

EGZAMIN Z JEZYKA ALBAŃSKIEGO

I. Ju lutem përpiloni një rezyme të artikullit të mëposhtëm në një faqe të shkruar me dorë. Ju lutem bëjeni këtë gjë me fjalët tuaja duke mos e cituar tekstin

Ata po ikin....

Një studim i fundit i Qendrës për Studime Ekonomike dhe Sociale gjeti se 70% e të rinjve që studiojnë në universitetet shqiptare kanë për qëllim të largohen nga vendi. Profili i ri i emigracionit pas liberalizimit të vizave ka përfshirë të gjitha grupmoshat e popullsisë në të gjitha qytetet e vendit, duke çuar drejt zbrazjes së shpejtë, por së fundmi ky proces ka përfshirë edhe stafet e kualifikuara në kompani me vlerë të shtuar dhe paga të larta. Profesor Ilir Gëdeshi, i cili po udhëheq një anketë kërkimore mbi këtë tematikë, pohon se gjetjet e para tregojnë se vala e re e emigracionit ndër njerëzit me aftësi të larta nuk ka të bëjë me ekonominë, por me rrethanat të cilat janë rënduar ndër vite dhe nuk ka shpresë të përmirësohen së paku në një afat të shkurtër. Një paketë e re ligjore, e pranuar së fundmi nga Gjermania, e cila lehtëson më tej kushtet e migrimit, pritet të nxisë emigracionin këtë vjeshtë. Të dhënat tregojnë se ritmi i ikjeve nga shqiptarët është më i larti në botë në raport me popullsinë, edhe në raport me vendet e luftës, ndonëse Shqipëria është një vend në paqe dhe që po punon prej vitesh të anëtarësohet në Bashkimin Europian, duke u renditur në listën e vendeve të sigurta. Të dhënat e Eurostat tregojnë se rreth 19 mijë shqiptarë kanë aplikuar për azil në një nga vendet e Bashkimit Europian në vitin 2018. Shqiptarët renditen në vend të nëntë për nga numri i azilkërkuesve në vlerë absolute, pas Sirisë, Afganistanit, Irakut, Pakistanit, Iranit, Nigerisë, Turqisë dhe Venezuelës. Në vend të parë, në vlerë absolute, është Iraku, me rreth 81 mijë aplikime. Por, në raport me popullsinë, shqiptarët vijnë të dytë në mesin e vendeve të cilat kanë më shumë aplikime për azilantë në raport me popullsinë. Me këtë filozofi të trajtimit të problemit, bizneset shqiptare janë lënë krejtësisht të pambrojtura, teksa mungesa e fuqisë punëtore në shumicën prej tyre u shndërrua në shqetësimin kryesor për vitin 2019. Në një rrafsh më të gjerë, industria e turizmit po vuan momentalisht për shkak të sezonalitetit në të cilin ndodhet. Altin Prenga, nga Mrizi i Zanave, i cili zotëron njësinë më të madhe të agroturizmit në vend, tha se, bizneset shqiptare duhet të ndryshojnë qasjen ndaj trajtimit të fuqisë punëtore, sidomos në drejtim të pagesave. Z. Prenga u shpreh se pagat në biznesin e tij për çdo hallkë të shërbimit janë vetëm 20 deri në 30% më të ulëta se në Itali. Me këtë pagë, asnjë i ri nuk do të dëshironte të shndërrohej një punonjës sezonal në Itali, Greqi apo gjetkë, pasi nuk do të kishte leverdi. Ai pohoi se, vetë gërmadha që po krijon

emigracioni mund të shndërrohet në një vetërregullim, pasi bizneset do të detyrohen të ofrojnë paga më të larta. Kjo ndikon shumë shpejt në frenimin e emigrimit të rinjve, tha Prenga. Për një kompani që kërkon kualifikim të lartë, hendeku që krijon emigracioni nuk riparohet me një pagë më të lartë. “Përmirësimi i kushteve të tjera, që lidhen me mjedisin, me infrastrukturën e shkollimit, shëndetin, mjedisin dhe zbatimin e ligjit kërkojnë kohë” thotë profesor Gëdeshi. Vendet e Ballkanit Perëndimor po bëjnë përpjekje për të frenuar fenomenin, teksa qeveria e Shqipërisë ka përgatitur një strategji kombëtare për qeverisjen e emigracionit, ku parashikohet që të larguarit t’i zëvendësojë me të huaj duke lehtësuar procedurat e qëndrimit të tyre në vend. Në dekadën e fundit ka një përmbysje të tendencës për emigrim, ku vala e të ikurve është zhvendosur nga të pashkolluarit, tek ata me edukim. Profesor Gëdeshi, i cili ka udhëhequr dy anketa mbi potencialin e emigrimit, njërën në vitin 2017 dhe tjetrën në vitin 2018, ka vënë re tendencën në rritje të emigrimit të personave të arsimuar. Të dhënat e anketës të vitit 2007 tregonin se sa më i ulët ishte niveli arsimor, aq më e lartë ishte dëshira për migrim. Kjo shpjegohej me faktin se njerëzit e paarsimuar dhe të pakualifikuar ishin të papunë ose kishin vështirësi në gjetjen e një pune në Shqipëri dhe dëshironin të migronin (kryesisht në Itali dhe Greqi). Ndërsa ata që zotëronin një profesion, ose kishin një arsimim më të lartë, e kishin më të lehtë të integroheshin në tregun e punës në Shqipëri. Anketa me emigrantët e kthyer në vitin 2007 tregonte se të kthyerit me arsim fillor kishin punuar në Greqi si punëtorë të pakualifikuar dhe shpesh në sektorin informal, çka nuk nxiste të tjerët të migronin. Në vitin 2007, rreth 40% e personave me arsim të lartë donin të largoheshin nga vendi. Në vitin 2018, kjo tendencë është rritur me 13 përqind, pasi 53.7% e personave me arsim të lartë kanë pohuar se po planifikojnë të largohen nga vendi. Dekadën e fundit ka një lidhje më të fortë midis edukimit dhe dëshirës për emigrim. Të dhënat e anketës sonë tregojnë se migrimi potencial është më i lartë për personat me edukim profesional, dytësor dhe të lartë. Ky fakt, nga njëra anë, shpjegohet me mundësitë më të mëdha të punësimit në Gjermani, në vendet e zhvilluara të BE dhe në Amerikën e Veriut. Nga ana tjetër, këtij interesi i përgjigjet pakënaqësia, mundësitë e pakta dhe kushtet e punës në Shqipëri.

tekst przygotowany na podstawie www.monitor.al

II. Ju lutem përkthejeni këtë tekst në gjuhën polake:

Ndërsa mijëra civilë në veri të Sirisë po përpiqen të shpëtojnë nga konflikti, marrëveshja për armëpushim 5-ditor është prishur nga episode sporadike. Ka raportime për sulme ajrore dhe se artileria turke ka vazhduar të godasë pozicionet e luftëtarëve kurdë, vendbanime civile dhe spitale. Flitet se shumë prej të plagosurve kanë në trup shenja të përdorimit të mundshëm të fosforit të bardhë nga ushtria turke. Ekspertët kimikë të OKB tashmë ndodhen në terren për të grumbulluar informacion dhe për të hetuar për këtë çështje. Forcat Kurdo-Siriane gjithashtu pretendojnë se kanë rrëzuar një helikopter turk midis Raqqa dhe kufirit me Turqinë. Duke folur në Stamboll, Presidenti Erdogan kërcënoi se do të rifillojë ofensivën para afatit 5-ditor, nëse kurdët e Njësitë të Mbrojtjes Popullore nuk do të braktisin zonën e sigurisë prej 30 kilometrash nga kufiri i Turqisë. Koalicioni kurdo-sirian e ka pranuar marrëveshjen e propozuar nga pala amerikane dhe e pranuar nga turqit, por ende nuk e ka hequr infrastrukturën ushtarake. Shumë analistë ushtarakë marrëveshjen midis Trump dhe Erdogan e cilësojnë jo si garanci për një zgjidhje politike për konfliktin, por më tepër si një ndihmë për projektet gjeopolitike të Ankarasë, e cila synon të vendoset në veri të Sirisë duke shuar aspiratat për krijimin e Kurdistanit.

Tekst przygotowany na podstawie www.gazetadita.al

III. Ju lutem zgjidhni një nga temat e mëposhtme dhe shkruani një ese në një faqe

1. Ndërkohë që Serbia dhe Mali i Zi kanë hapur tashmë procesin e integritit evropian, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk morrën miratimin për hapjen e negociatave me BE. Cilat janë perspektivat e integritit evropian të Ballkanit Perëndimor?
2. Ngrohja globale është tashmë një problem mbarëbotëror. Cilat janë hapat e mundshme që mund të marrë secili prej nesh për të ulur efektin negativ që ka ngrohja globale në jetën tonë të përditshme?
3. Pas rënies së komunizmit dhe ndryshimeve rrënjësore sociale, kulturore dhe ekonomike, ka ndryshuar edhe modeli i jetës së përditshme, si në qytete, ashtu edhe në fshatra. Cilat janë tendencat dhe drejtimet kryesore të këtyre ndryshimeve dhe ku duken ato në kuadrin e jetës shoqërore në qytet dhe në fshat?

IV. Ju lutem plotësoni mungesat duke zgjedhur formën e saktë nga njëra prej formave të propozuara nga A në D. Ju lutem shkruajini përgjigjet në një faqe të veçantë letre:

Borxhi i Serbisë ndaj pensionistëve të Kosovës afër 3 miliardë euro

Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) (1.....) prezantuar studimin e radhës lidhur (2.....) fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Kosovës si dhe raportet bilaterale Kosovë-Serbi (3.....) sektorin e energjisë. Në të dyja këto fusha, sipas këtij Instituti, Kosova është duke humbur vlera të mëdha (4.....). Në konferencën e organizuar me këtë rast u shpalosën disa nga gjetjet kryesore dhe rekomandimet nga studimi në fjalë. Hulumtuesja nga RIDEA, Mrika Kotorri, ka treguar se shuarja dhe përvetësimi i pagesës (5.....) të kosovarëve nga ana e Serbisë i ka penguar pensionistët kontributdhënës në shfrytëzimin e pasurisë së tyre. “Fondi i Sigurimit Pensional (6.....) menaxhuar nga Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor (BVI-SPI) si një sistem (7.....) dhe i bazuar në parimin e solidaritetit mes gjeneratave. Fondi ka ofruar mjete për siguri materiale dhe shëndetësore (8.....) janë siguruar në bazë të punës dhe kontributit (9.....). Fondi ka luajtur një rol të rëndësishëm socio-ekonomik për mirëqenien e përfituesve dhe ka shërbyer si një mjet i rëndësishëm financiar kundër (10.....) në pleqëri. Prandaj shuarja dhe (11.....) i jashtëligjshëm i BVI-SPI dhe suspendimi i jashtëligjshëm i pagesës së pensioneve nga ana e Serbisë i ka penguar pensionistët kontributdhënës në (12.....) e qetë të pasurisë së tyre”. Sipas raportit për (13.....) e pensioneve nga viti 1999 deri në vitin 2016, vlera e borxhit që Serbia ka ndaj Kosovës është 2 miliardë e 849 mijë e 907 euro. Raporti i rekomandoi shtetit serb që zyrtarisht (14.....) pranojnë përgjegjësinë për dëmin në para dhe dëmin jo-pasuror që u ka shkaktuar pensionistëve kontributdhënës si dhe t’u kërkojë falje këtyre të fundit për dëmet që (15....) ka bërë. (16.....) folur për marrëveshjet energjetike midis Kosovës dhe Serbisë, hulumtuesi Bekim Krasniqi tha se ato nuk janë zbatuar dhe shumë (17.....) janë shkelur nga shteti fqinj. Krasniqi tregoi se borxhi nga faturat e energjisë elektrike të pjesës veriore të banuar me shumicë serbe, ka kaluar shifrën 200 milionë euro. “Marrëveshja që buron nga dialogu i Brukselit nuk (18.....) zbatuar, pra kemi shkelje të marrëveshjes. Serbia ka dërguar kërkesë për rishikimin e kësaj marrëveshje duke bërë shkelje. Mospagesa e faturave të energjisë në pjesën veriore (19.....) sot ka arritur vlerën 204 milionë euro”. Ndryshe, shteti i Serbisë kishte ndaluar kontributet e pensionistëve të Kosovës nga qershori i vitit 1999, pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë. Që nga atëherë, pensionistët e periudhës para vitit 1999 nuk kanë arritur të marrin paratë e tyre nga ky fond, (20.....), sipas Shoqatës së Pensionistëve, tashmë një numër i konsiderueshëm edhe kanë ndërruar jetë dhe mbetet e diskutueshme edhe çështja e trashëgimit të pensionit.

- | | | | |
|----------------------|------------------|-------------------|---------------------|
| 1. A. ka | B. ja | C. fa | D. ta |
| 2. A. te | B. ve | C. me | D. le |
| 3. A. vë | B. në | C. më | D. të |
| 4. A. paratë | B. parash | C. paraja | D. parave |
| 5. A. së pensioneve | B. së pensionet | C. të pensioneve | D. në pensione |
| 6. A. u | B. ka | C. është | D. na |
| 7. A. e pavarur | B. i pavarur | C. o pavarur | D. a pavarur |
| 8. A. e cilat | B. i cilat | C. të cilat | D. të cilave |
| 9. A. të detyrueshme | B. i detyrueshëm | C. të detyrueshëm | D. e detyrueshëm |
| 10. A. skamjet | B. skamjes | C. skamjesh | D. skamja |
| 11. A. përmirësimi | B. përgjithësimi | C. përvetësimi | D. përkrahësimi |
| 12. A. shfrytëzimin | B. shpyllëzimin | C. frytëzimin | D. shpërfytyrëzimin |
| 13. A. kohën | B. çështjen | C. punën | D. mishin |
| 14. A. na | B. ka | C. ua | D. ta |
| 15. A. a | B. i | C. u | D. e |
| 16. A. Pa | B. Duke | C. Ka | D. Je |
| 17. A. tyre | B. prej tyre | C. prej to | D. prej ato |
| 18. A. është | B. janë | C. jetë | D. ka |
| 19. A. prej nga | B. deri më | C. nga | D. nëpërmjet |
| 20. A. kur | B. ndërkohë që | C. që | D. si |